

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7177
E mërkurë, 1 maj 2024
Çmimi 0.50 €

Policia sqaron se pse vendosi kamera në katër komunat veriore

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

'DËNIME TË BUTA', MBI 230 MIJË ARMË PA LEJE NË DUART E QYTETARËVE

FAQE 4-5



Mbi 230 mijë armë pa leje janë në duar të qytetarëve të Kosovës, llogarit Ministria e Punëve të Brendshme në

vend, që i bie se çdo i shtati qytetar i Kosovës ka një armë pa leje. Gjykatat thuhet se vazhdimisht

shqiptojnë dënime me gjobë dhe me kusht, e shumë rrallë dënime me burgim efektiv

KOSOVA MERR GRANT MBI 200 MILIONË EURO NGA AGJENCIA MCC E QEVERISË AMERIKANE

F. 3



IKD-ja PUBLIKON 'DORACAKUN PËR SHPALLJEN E GREVËS SË LIGJSHME': NDALJA E PAGËS PËR GREVISTËT E 'MBYT' ORGANIZIMIN SINDIKAL

F. 5

AKTUALE



KOSOVA KËRKON NDIHMËN E ITALISË PËR ANËTARËSIM NË KËSHILLIN E EVROPËS

F. 6

GËRVALLA NË BRUKSEL MERR PJESË NË TAKIMIN E MINISTRAVE TË JASHTËM DHE ATYRE PËR EVROPË TË BE-së

F. 5

BE-ja: NË KOSOVË MBËSHTESIM NJË STRUKTURË TË VETME INSTITUCIONALE SIPAS KORNIZËS SË SAJ LIGJORE

F. 2

EKONOMI



GJERMANIA ZOTON 90 MILIONË EURO PËR PUNËSIM, ENERGJI DHE INTEGRIM TË KOSOVËS NË BE

F. 8

BREGU ME RASTIN E DITËS SË PUNËTORËVE: PABARAZITË GJINORE VAZHDOJNË NË FUQINË PUNËTORE

F. 8

SPORT



TJETËR PËRBALLJE MES DORTMUNDIT DHE PSG-së

F. 12

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja: Në Kosovë mbështesim një strukturë të vetme institucionale sipas kornizës së saj ligjore

PRISHTINË, 30 PRILL - Bashkimi Evropian tha se mbetet në qëndrimin e shprehur më herët se në Kosovë mbështet vetëm një strukturë të vetme institucionale dhe administrative, sipas kornizës ligjore të Kosovës. Por, në të njëjtën kohë, blloku u shpreh se çështja e institucioneve që mbështeten nga Serbia duhet të zgjidhen përmes themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Kështu tha zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, në pyetjen e "Radios Evropa e Lirë" se cili është qëndrimi i BE-së lidhur me strukturat e Serbisë në territorin e Kosovës. "Të gjitha marrëveshjet e kaluara të dialogut janë plotësisht të harmonizuara me parimin e një strukturë të vetme institucionale dhe administrative, dhe ato ndjekin kornizën ligjore dhe institucionale të Kosovës, siç konfirmohet nga konkluzionet e Këshillit Evropian", tha Stano në përgjigjen dërguar REL-it.

Çështja e institucioneve serbe në Kosovë u ngrit gjatë takimit të fundit të kryenegociatorëve të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel më 25 prill, kur u diskutua për çështjen e dinarit serb. Gjatë takimit pala serbe ka kërkuar që të gjitha institucionet serbe, që Kosova i konsideron ilegale, të vazhdojnë të financohen nga

Beogradi deri në kohën kur të krijohet Asociacioni.

Sipas sqarimit të Stanos, statusi i strukturave të mbështetura nga Serbia është paraparë të zgjidhet në kuadër të dialogut, përkatësisht përmes themelimit të Asociacionit. Ai i bëri thirrje Kosovës të lëvizë drejt themelimit të Asociacionit pa vonesa në përputhje me draft-statutin e propozuar nga BE-ja vitin e kaluar.

Kosova dhe Serbia kanë arritur dy marrëveshje për Asociacionin, më 2013 dhe 2015. Por, Kosova ende nuk ka ndërmarrë hapa drejt themelimit të tij.

Gjithashtu, BE ka kërkuar nga të dyja palët të përmbahen nga çdo veprim i njëanshëm në terren që nuk kontribuon në krijimin e një mjedisi të favorshëm për bisedime për normalizimin e marrëdhënieve dhe që Kosova dhe Serbia të angazhohen për t'i zgjidhur të gjitha çështjet e pazgjidhura në dialogun që ndërmjetëson blloku.

Në takimin e fundit në kuadër të dialogut të zhvilluar në Bruksel, palët morën nga ndërmjetësi i dialogut, Miroslav Lajçak, një propozim kompromisi për mundësimin e pagesave nga Serbia për përfituesit në territorin e Kosovës dhe pritet që deri në takimin e radhës palët të shprehen për atë propozim.



Kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, pas takimit deklaroi se Beogradi synon ta vazhdojë financimin e të gjitha strukturave paralele në Kosovë, pa treguar se cilat janë ato. Ai tha se propozimi i Lajçakut synon t'i përafrojë qëndrimet e palëve sa i përket çështjes së ndihmës financiare nga Serbia për serbët në Kosovë. "Qëndrimi i palës serbe është që të gjitha strukturat ilegale të Serbisë duhet të financohen, të vazhdojnë të financohen deri në kohën kur të krijohet Asociacioni [i Komunave me Shumicë Serbe] sepse, sipas

mendimit të tyre, qëllimi i Asociacionit nuk është të sigurojë koordinim të mirë mes komunave, por ta sigurojë legjitimizimin e pranisë së institucioneve serbe në Kosovë, që do t'i bënte ato institucione gjysmëserbe, por jo institucione të serbëve në Kosovë", tha Bislimi pas takimit në Bruksel. Ai shtoi se kjo ide e Serbisë nuk gjeti mirëkuptimin as të Kosovës, as të ndërmjetësit të dialogut, Miroslav Lajçak. Në anën tjetër, në BE vazhdojnë të bëjnë dallimin mes "strukturave të Serbisë" dhe

strukturave "të mbështetura nga Serbia", duke përsëritur se në Kosovë duhet të ketë vetëm një strukturë unike institucionale. Por, në të njëjtën kohë duhet mundësuar financimin e strukturave që deri më tash kanë pasur mbështetje financiare nga Serbia. Nga Brukseli vetëm kërkohet që kjo të sigurohet përmes një zgjidhje afatshkurter në kuadër të dialogut për t'i tejkaluar pengesat që janë paraqitur pas vendimit të Bankës Qendrore të Kosovës, që lejon vetëm monedhën euro të përdoret për kryerjen e pagesave.

GjND-ja refuzon kërkesën që Gjermania ta ndalë ndihmën për Izraelin

HAGË, 30 PRILL - Gjykata kryesore e Kombeve të Bashkuara ka refuzuar kërkesën e Nikaraguas që Gjermania të urdhërohet ta ndalojë ndihmën ushtarake dhe ndihmën tjetër për Izraelin dhe ta rinisë financimin për agjencinë e OKB-së për ndihmë në Gazë.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND) tha se kushtet ligjore për të lëshuar një urdhër të tillë nuk u plotësuan, prandaj kërkesa u refuzua me 15 vota për dhe një kundër. "Bazuar në informacionin faktik dhe argumentet ligjore të paraqitura nga palët, gjykata vjen në përfundim se rrethanat për të ushtruar një fuqi të tillë për ndërmarrjen e masave të përkohshme nuk janë plotësuar", tha presidenti i GjND-së, Nawaf Salam.

Megjithatë, paneli prej 16 gjyqtarësh nuk e hodhi poshtë të gjithë rastin, që nënkupton se rasti do të vazhdojë të trajtohet në seancat dëgjimore. Salam tha se gjykata "vazhdon të jetë thellësisht e shqetësuar me kushtet katastrofale të jetesës së palestinezëve në Rripin e Gazës, veçmas sa i përket privimit të gjërë nga ushqimi dhe kushteve



të tjera elementare".

Gjatë seancës dëgjimore, Gjermania ka argumentuar se pothuajse nuk ka eksportuar armë në Izrael që kur Izraeli nisi ofensivën në Gazë, pas sulmit vdekjeprurës të Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian ndaj Izraelit më 7 tetor. Nikaragua, një aleate e kamotshme e palestinezëve, pretendoi se Gjermania po mundëson të kryhet gjenocid

duke dërguar armë dhe mbështetje tjetër për Izraelin. Vendimi i GjND-së ka të bëjë vetëm me urdhrat paraprake në këtë rast, i cili me gjasë do të marrë vite kohë që të zgjidhet. Gjermania mohon pretendimet e ngritura nga Nikaragua. Izraeli, që nuk është palë në rastin mes Nikaraguas dhe Gjermanisë, mohon fuqishëm se sulmi i tij në Gazë përbën akt të gjenocidit dhe insiston se po vepron në vetëmbrojtje. Rasti i ngritur nga Nikaragua

është beteja e fundit ligjore e ngritur nga një shtet që ka lidhje historike me popullin palestinez, rast që synon ta ndalë ofensivën e Izraelit. Vitin e kaluar Afrika e Jugut në këtë gjykatë e akuzoi Izraelin për gjenocid. Rasti në GjND vjen në kohën kur aleatët e Izraelit po përballen me thirrjet që të mos e furnizojnë me armë këtë shtet. Gjatë një seance dëgjimore në herët gjatë këtij muaji, ambasadori i Nikaraguas në

Holandë, Carlos Jose Arguello Gomez, tha se "Gjermania po dështon t'i respektojë obligimet e saj që ta parandalojë gjenocidin dhe të sigurohet që po respektohet ligji humanitar ndërkombëtar".

Nikaragua, po ashtu, dëshiron që Gjermania t'i rinisë fondet për agjencinë e OKB-së për ndihmë në Gazë.

Ekipi ligjor i Gjermanisë ka argumentuar se pretendimi i Nikaraguas "nuk është i bazuar në fakte apo ligje".

Lufta në Gazë nisi pasi më 7 tetor Hamasi sulmoi jugun e Izraelit, duke vrarë afër 1 200 persona dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë. Izraeli thotë se grupi radikal palestinez ende po mban afër 100 pengje, përfshirë mbetjet mortore të më shumë se 30 personave.

Ofensiva izraelite në Gazë ka vrarë më shumë se 34 000 palestinezë, sipas zyrtarëve lokalë shëndetësorë. Lufta ka detyruar 80 për qind të popullatës së Gazës që të largohet nga shtëpitë, ka shkakuar shkatërrim të madh dhe ka shtyrë banorë në veri të enklavës buzë urisë.

Kosova merr grant mbi 200 milionë euro nga agjencia MCC e Qeverisë Amerikane



Granti prej mbi 200 milionë eurosh nga agjencia MCC e Qeverisë Amerikane do ta transformojë thellësisht sektorin tonë të energjisë, kështu ka thënë presidentja Vjosa Osmani pas takimit në Prishtinë me zëvendëspresidentin e MCC-së, Cameron Alford. “Si investimi më i madh në fushën e energjisë, Programi Kompakt është dëshmi e fuqisë së partneritetit Kosovë - ShBA”, ka thënë Osmani

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 30 PRILL - Zëvendëspresidenti i Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), Cameron Alford, ka takuar të martën në Prishtinë presidenten Vjosa Osmani, kryeparlamentarin Glauk Konjufca dhe kryeministrin Albin Kurti. Presidentja Osmani e ka pritur Alfordin në prag të fillimit zyrtar të Programit Kompakt. Në takim u diskutua për fillimin zyrtar të Programit Kompakt, me ç'rast presidentja Osmani theksoi se granti prej mbi 200 milionë eurosh nga MCC-ja do ta transformojë

thellësisht sektorin tonë të energjisë. Më tutje, Osmani tha se ky program do të japë kontribut strategjik në përmirësimin e infrastrukturës energjetike, fuqizimin e sektorit privat, si dhe do t'i nxisë mundësitë ekonomike për qytetarët e Kosovës. Në këtë frymë presidentja Osmani shprehu mirënjohjen e saj për mbështetjen e vazhdueshme të MCC-së, ndërsa theksoi se Programi Kompakt është investimi më i madh në fushën e energjisë dhe shërben si dëshmi e fuqisë së partneritetit Kosovë - ShBA. Presidentja, po ashtu, theksoi se ky program do ta garantojë një të ardhme energjetike ku gratë do të kenë rol kyç dhe do të jenë

kontribuuese aktive në adresimin e sfidave të së ardhmes në fushën e energjisë.

Edhe Konjufca priti në takim zëvendëspresidentin e Operacioneve Kompakte të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC), Cameron Alford, i cili ishte i shoqëruar nga ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier.

Sipas njoftimit, në takim u bisedua për bashkëpunimin aktual ndërmjet Kosovës dhe MCC-së, përfshirë çështjen e nisjes së Programit Kompakt multimilionësh për sektorin e energjisë, si dhe u shqyrtuan planet për të ardhmen dhe çështje të tjera të interesit të përbashkët.

Kryetari Konjufca falënderoi përfaqësuesit e Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit dhe theksoi rëndësinë e projekteve me ndikim pozitiv në mirëqenien e qytetarëve, duke shprehur njëherësh mirënjohje për kontributin e çmuar të MCC-së në ecurinë zhvillimore të Republikës së Kosovës. Ai ritheksoi, po ashtu, gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit të ngushtë edhe në

të ardhmen.

Zëvendëspresidenti i MCC, Cameron Alford, u shpreh i kënaqur me nivelin e bashkëpunimit dhe potencoi nevojën e angazhimit të mëtejshëm për realizimin e projekteve zhvillimore në linjë me avancimin e kuadrit legjislativ që mbështet investimet.

Takimi u vlerësua si një rast i mirë për forcimin e bashkëpunimit dhe avancimin në drejtim të qëllimeve të përbashkëta për zhvillim të gjithmbarshëm.

Alfordin e ka takuar edhe kryeministri Albin Kurti, të cilin e uroi për këtë fillim të ri e të rëndësishëm për Kosovën, përmes funksionalizimit të programit të përbashkët të Kosovës në mbështetje dhe bashkëpunim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kryeministri njoftoi Alfordin me suksesin në ankandin e energjisë solare dhe me strategjinë ambicioze të qeverisë për energji, që shërben edhe si platformë e punës së Kompaktit.

Më tej, bashkë me ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe

ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, njoftoi Alfordin me vizionin e qeverisë në kuptim të zhvillimit të ekonomisë dhe rritjes së punësimit përmes investimit në aftësimin profesional, investimin në energji dhe në përgatitjen e kuadrove të reja në fushat STEM përmes bursave të studimit.

Programi Kompakt i cili komponentë kryesore ka ndërtimin e kapaciteteve akumuluese të energjisë, parasheh edhe komponentë të rëndësishme për zhvillim të kapaciteteve njerëzore e rritje të barazisë gjinore në sektorin e energjisë në vend. Programi Kompakt ka vlerë prej 236.7 milionë dollarësh, nga të cilat 202 janë grant nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kurse 34.7 milionë janë bashkëfinancim nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Së bashku me MCC dhe MCA, ashtu si me shumë projekte dhe programe të tjera të USAID-it, e në partneritet me ShBA-në, Qeveria e Republikës së Kosovës zotohet t'i zbatojë programet në përpikëri dhe në dobi të qytetarëve të saj.

Nënshkruhet memorandumi mbi 350 mijë euro në mes të Aliut dhe Atiqit

PRISHTINË, 30 PRILL - Ministri i Infrastrukturës, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Liburn Aliu, ka nënshkruar

memorandum me kryetarin e komunës së Mitrovicës së Veriut, Erden Atiq. Aliu ka bërë me dije se vlera e memorandumit është

368 mijë euro. “Përmes këtij memorandumi po ta bëjmë financimin e tërësishëm të projektit infrastrukturor: Projekti

i Rrugës ‘Çlirimi’, ‘Luj Braj’, ‘Norbert Jokli’ dhe ‘Boro Stankoviç’”, ka shkruar Aliu në “Facebook”.





'Dënime të buta', mbi 230 mijë armë pa leje në duart e qytetarëve

Mbi 230 mijë armë pa leje janë në duart të qytetarëve të Kosovës, llogarit Ministria e Punëve të Brendshme në vend. Shprehur ndryshe, çdo i shtati qytetar i Kosovës ka një armë pa leje. Gjykatat thuhet se vazhdimisht shqiptojnë dënime me gjobë dhe me kusht, e shumë rrallë dënime me burgim efektiv

PRISHTINË, 30 PRILL - Mbi 230 mijë armë pa leje janë në duart të qytetarëve të Kosovës, llogarit Ministria e Punëve të Brendshme në vend. Shprehur ndryshe, çdo i shtati qytetar i Kosovës ka një armë pa leje. Policia thotë se deri më tash këtë vit ka konfiskuar 430 armë të tilla.

Sipas të dhënave të saj, nga viti 2020 deri më 18 prill të këtij viti janë ngritur 5 895 raste në gjykata lidhur me veprën penale: "mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve".

Ekspertë të sigurisë dhe përfaqësues të shoqërisë civile kërkojnë përpjekje të shtuara për konfiskimin e tyre, duke thënë se qytetarët që i kanë ato, cenojnë sigurinë publike, por edhe veten. Vetëm gjatë prillit në Kosovë u vranë dy gra - njëra në Ferizaj, tjetra në Pejë. Policia konfirmoi se të dyshuarit për vrasje - në të dyja rastet bashkëshortët - përdorën armë pa leje.

Policia nuk iu përgjigj pyetjes së "Radios Evropa e Lirë" se sa është numri i vrasjeve në Kosovë deri më tash këtë vit. Por, vitin e kaluar ky institucion i konfirmoi REL-it se në periudhën janar-tetor 2023, u evidentuan 26 vrasje, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2022 ishin 21. Organizatat joqeveritare që monitorojnë sistemin e

drejtësisë në Kosovë, konsiderojnë se dënimet e ulëta për armëmbajtje pa leje, bëjnë që shumë qytetarë të kenë armë të tilla.

Për armëmbajtje pa leje, Kodi Penal i Republikës së Kosovës parasheh gjoba deri në 7 500 euro ose dënim me burgim deri në 10 vjet.

"Rrallë dënime me burgim efektiv"

Lavdim Makshana nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) thotë se rastet e armëmbajtjeve pa leje, gjykatat "i trajtojnë me politika të buta ndëshkimore". "Në vazhdimësi, ato gjykojnë sikur të ishin kundërvajtje, ani pse parashihen dënime të rënda. Gjykatat vazhdimisht shqiptojnë dënime me gjobë dhe me kusht, shumë rrallë dënime me burgim efektiv", thotë Makshana për "Radion Evropa e Lirë".

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) thotë po ashtu se, gjatë monitorimit të proceseve gjyqësore, ka vërejtur mangësi "sa i përket konsistencës dhe arsytimit të vendimeve ndëshkimore për posedim të paligjshëm të armëve".

Më 16 prill, OSBE-ja publikoi raportin "Politika ndëshkimore në rastet e posedimit të

paligjshëm të armëve", ku analizoi 33 raste në lidhje me këtë veprë penale, nga dhjetori i vitit 2020 deri në gusht të vitit 2023.

Prej tyre, 31 rezultuan me gjobë nga 200 deri në 2 000 euro, ndërsa, në dy raste, të pandehurit u dënuan me burgim me kusht, 90 ditë, përkatësisht gjashtë muaj.

Gjobat më të shpeshta ishin 400 euro në nëntë raste, ndërsa maksimalja prej 2 000 eurosh u shqiptua vetëm në një rast.

Në vitin 2019, një raport të ngjashëm publikoi edhe IKD-ja, e cila analizoi gati 200 raste të armëmbajtjeve pa leje. Prej tyre, në 133 raste gjykatat shqiptuan gjoba, në 46 dënime me kusht dhe në 19 dënime me burgim. Makshana thotë se IKD-ja ka kërkuar disa herë që të shqiptohen dënime më të rënda, në mënyrë që armëmbajtja pa leje të reduktohet.

Pas rastit të vrasjes në Ferizaj, më 12 prill, ministria e Drejtësisë e Kosovës, Albulena Haxhiu, kërkoj po ashtu "ashpërsim të dënimeve për armëmbajtje pa leje", si dhe "të analizohet sesi sigurohen ato armë".

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk iu përgjigj pyetjeve të Radios Evropa e Lirë se sa është numri i përgjithshëm i aktgjyqimeve për këtë veprë penale në katër vjetët e fundit, si dhe sa raste janë dënuar me burg efektiv, ndëshkim me gjobë apo kusht.

Armët pa leje - "rrezik për sigurinë publike"

Disa qytetarë, të anketuar nga Radio Evropa e Lirë në Prishtinë, shprehën të shqetësuar me

numrin e armëve pa leje që qarkullojnë në Kosovë.

Xhemajl Abrashi thotë se organet e rendit duhet t'i rrisin kontrollin, por edhe vetë qytetarët, sipas tij, duhet ta informojnë policinë nëse kanë informata se dikush mban armë pa leje. "Sa vrasja është duke ndodhur... Ai që ka armë, vret, dhe jo ai që nuk ka", thotë ai.

Bukurije Hoxha thotë se vrasjet që po ndodhin, duhet të jenë alarm për policinë. "Edhe një vrasje brenda vitit të ndodhë, është shumë", sipas saj.

Eksperti i çështjeve të sigurisë, Drizan Shala, nga Asociacioni i Kriminologëve dhe Kriminolistëve të Kosovës, thotë se policia duhet t'i rrisë kontrollin nëpër vetura, sepse, nisur nga raportet e saj, armët pa leje shumë shpesh gjenden në vetura. "Shumë armë që kanë mbetur si rezultat i luftërave të fundit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, janë në duart e qytetarëve. Ato nuk e rrezikojnë vetëm sigurinë publike, por mund të kenë edhetribute drejt cenimit të sigurisë nacionale", thotë Shala për Radion Evropa e Lirë.

Ai shton se autoritetet kompetente duhet të mbajnë fushata të ndërgjegjësimit, në mënyrë që qytetarët që posedojnë armë pa leje, t'i dorëzojnë ose të pajisen me leje. Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, për nëntë muaj të vitit 2019, realizoi një proces të legalizimit të armëve, ku u dorëzuan rreth 2.000 kërkesa.

Një proces i tillë i legalizimit "duhet të ndodhë prapë, por mbetet të përcaktohet me ligj", thonë nga MBP-ja për Radion Evropa e Lirë.

Kush mund të pajiset me armë?

Ligji për armët në Kosovë parasheh përmbushjen e disa kushteve për t'u pajisur me armë. Mes tyre janë: mosha 21-vjeçare, aftësia ligjore për veprim, aftësia psiko-fizike, të mos rrezikojë veten, sigurinë publike, si dhe të deklarojë arsyen e blerjes së armës.

Por, arma, përkundër lejes, mund të konfiskohet me vendim gjyqësor, nëse poseduesi humb aftësinë e veprimit, aftësinë psiko-fizike, dënohet për veprë penale ose shkel kushtet e përcaktuara.

Nga Ministria e Brendshme e Kosovës nuk dhanë informacione se sa është numri i armëve me leje në Kosovë, por thanë se "deri në vitin 2010 ishin rreth 35 000 armë të regjistruara në administratën e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Tani, këto armë janë duke u regjistruar gradualisht sipas Ligjit të armëve".

Në Kosovë janë të licencuara disa poligone dhe dyqane, të cilat shesin armë në mënyrë legale.

Radio Evropa e Lirë bisedoi me disa pronarë të këtyre dyqaneve, të cilët treguan se çmimet e armëve shkojnë deri në 4.500 euro, varësisht llojit.

Sipas tyre, interesim për blerje ka dhe arsyeja e blerësve kryesisht lidhet me shenjëtari.

Dogana e Kosovës nuk iu përgjigj interesimit të REL-it se nga cilat shtete importohen armët në Kosovë, por pronarë të dyqaneve thanë se, në shumicën e rasteve, ato vijnë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqia dhe Çekia.

IKD-ja publikon 'Doracakun për shpalljen e grevës së ligjshme': Ndalja e pagës për grevistët e 'mbyt' organizimin sindikal

PRISHTINË, 30 PRILL - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) dhe Sindikata e Bashkuar, të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës të Kosovës (SBASHK), me përkrahje të Programit për Angazhim Qytetar, të martën kanë publikuar "Doracakun për shpalljen e grevës së ligjshme".

Në kuadër të këtij doracaku është mbajtur edhe një diskutim, ku nga të pranishmit është thënë se ndalja e pagave për grevistët është

"mbytje për organizimin sindikal". Hulumtues i lartë në Institutin e Kosovës për Drejtësi, Naim Jakaj, ka thënë se ndalja e pagave për grevistët nënkupton mbytje të organizimit sindikal. Ai ka thënë se pasojat e grevës nuk duhet të shikohen vetëm te pagat, por dëmi që shkaktohet nga grevat te secili sektor.

Ndërsa kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), Atdhe Hykolli, ka thënë se "Doracakut për shpalljen e grevave të ligjshme" do t'u

ndihmojë në realizimin e të gjitha kërkesave në lidhje me grevën.

Në anën tjetër, kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës të Kosovës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka thënë se kërkesat e tyre në protestën e së mërkurës janë legjitime dhe se motoja është "Duam dialog social".

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) do të protestojë të mërkurën para objektit të Qeverisë së Kosovës.

Sipas një njoftimi për medie bëhet me dije se tubimi i protestuesve do të bëhet nga ora 10:30 deri në orën 11:00 në oborrin e Bibliotekës Kombëtare për të vazhduar deri te ndërtesa e qeverisë. "Në orën 11:00 fillon marshimi drejt MASHTI-t. Protestuesit këtu ndalën 5 minuta e pastaj vazhdojnë në koristë në anën e djathtë drejt konvikteve. Nga aty vazhdojnë marshimin drejt Katedrales e nga aty drejt Hotel 'Grand'-it dhe Sheshit 'Zahir Pajaziti' për të vazhduar nëpër

shesh deri te ndërtesa e qeverisë. Me të arritur (rreth orës 12:00) aty kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj përmes mikrofonit shpalos kërkesat e anëtarësisë drejtuar qeverisë. Pastaj flet kryetari i BSPK-së, Atdhe Hykolli. Pas tij kryetari nga sektori privat Isuf Azemi i drejtohet qeverisë me kërkesat e veçanta në emër të anëtarësisë që përfaqëson. Në orën 12 e 30 shpallet e mbyllur protesta dhe protestuesit shpërndahen në mënyrë të qetë", ka njoftuar SBASHK-u.



Gërvalla në Bruksel merr pjesë në takimin e Ministrave të Jashtëm dhe atyre për Evropë të BE-së

PRISHTINË, 30 PRILL - Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, me ftesë të Presidencës belge të Këshillit të BE-së, ministres së Punëve të Jashtme, Çështjeve Evropiane dhe Tregtisë së Jashtme, Hadja Lahbib, po merr pjesë në takimin ministror të BE-së në Bruksel, në 20-vjetorin e zgjerimit, kur 10 shtete të reja anëtare iu bashkuan Bashkimit Evropian në vitin 2004.

Gjatë sesioneve do të diskutohet rreth sfidave, nevojave dhe praktikave më të mira dhe reformave të sundimit të ligjit në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së.

Në këtë takim, i cili mbledh ministrat e shteteve anëtare të

BE-së dhe atyre me perspektivë anëtarësimi, Republika e Kosovës do t'i paraqesë të arriturat e saj në procesin e integritit në BE, reformat e thella të ndërmarrja në sundim të ligjit dhe fusha të tjera, të evokojë rreth proceseve nëpër të cilat po kalojmë dhe nevojën e ndërmarrjes së veprimeve për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor.

Ministrja Gërvalla do të realizojë edhe takime bilaterale me ministra të jashtëm dhe të çështjeve të BE-së për të diskutuar rreth marrëdhënieve dypalëshe dhe proceset nëpër të cilat po kalon Kosova, në veçanti rreth procesit të anëtarësimit në Këshillin e Evropës.



Osmani nderon 280 martirët e Vërbocit dhe Shtuticës dhe 43 dëshmorët e UÇK-së

PRISHTINË, 30 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka bërë homazhe në Vërboc dhe Shtuticë, në 25-vjetorin e masakrave në këto dy fshatra dhe në fshatrat përreth: Tërstenik, Dashec, Baks, Gllobar, ku forcat e regjimit gjoenocidal të Serbisë më 30 prill 1999, vranë mizorisht 280 civilë shqiptarë. "Sa më afër lirisë,

brutaliteti i forcave të regjimit gjenocidal të Serbisë rritej e manifestohej në mënyrën më çnjerëzore, ndaj në ofensivën e tyre vranë 280 banorë të kësaj ane vetëm pse ishin shqiptarë. Në mbrojtje të popullsisë civile u vunë vajza dhe djem të UÇK-së në krye me komandant Ilaz Kodrën. Përballë egërsisë së regjimit kriminal, Ilazi me 42

bashkëluftëtarë qëndruan me guxim dhe vendosmëri deri në flajm. Ata ranë në fushë të betejës, duke u bërë të pavdekshëm", ka theksuar presidentja Osmani. Presidentja Osmani tha se sakrificat e heronjve dhe dëshmorëve të UÇK-së nuk do të harrohet kurrë, ndërkaq guximi i tyre do të mbahet mend gjithmonë.



Kosova kërkon ndihmën e Italisë për anëtarësim në Këshillin e Evropës

PRISHTINË, 30 PRILL - Komisioni i Kuvendit të Kosovës për Punë të Jashtme dhe Diasporë, si dhe Komisioni për Integrim Evropian, priten të martën në takim një delegacion nga Kuvendi i Italisë. Takimin e kryesoi Arbëreshë Kryeziu - Hyseni, kryetare e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, e cila foli për marrëdhëniet ndërshtetërore, për të cilat tha se janë të hershme dhe shumë të ngushta.

Ajo, po ashtu, falënderoi mysafirët për angazhimin e tyre si dhe shtetin italian për ndihmën e ofruar Kosovës në të gjitha fazat e zhvillimit të saj.

Kryetarja Kryeziu - Hyseni u angazhua dhe kërkoi ndihmën e mëtejme nga Italia për



përmbylljen e procesit të anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës.

Në emër të Komisionit për

Integrim Evropian foli nënkryetarja e këtij Komisioni, Fjolla Ujkani. Ajo vuri në dukje angazhimet parlamentare për

integrimin e vendit, ndërsa foli edhe për sfidat që burojnë nga shantazhet dhe pengesat që shfaqen në këtë proces.

Në vijim të takimit u diskutua për një gamë të gjerë çështjesh që ndërlidhen me procesin e integritimit. Me këtë rast u vu në spikamë nevoja e ngutshme për krijimin e një shtete të qetë dhe të qëndrueshme për tërë rajonin. Në emër të delegacionit italian foli Lia Quartapelle, e cila raportet ndërshtetërore i cilësoi si shumë miqësore dhe të qëndrueshme, ndërkaq u angazhua në gjetjen e një zgjidhje për të gjitha sfidat që e përcjellin Kosovën në rrugën e saj të integritimit. Ajo i siguroi nikoqirët e këtij takimi se Italia do të jetë mbështetëse e Kosovës në përpjekjet e saja integruese pavarësisht prej sfidave që mund të paraqiten.



Edhe zyrtarisht themelohet Muzeu i Masakrës në Krushë të Madhe

RAHOVEC, 30 PRILL - Në pikën e dymbëdhjetë të seancës së rregullt të Kuvendit Komunal të Rahovecit, në praninë e profesorëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", të studentëve të Departamentit të Antropologjisë - Fakultetit Filozofik, Fakultetit të Arkitekturës, Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" dhe përfaqësues nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore - Prizren, u shqyrtua dhe u miratua në mënyrë unanime propozim-vendimi për themelimin e Muzeut të masakrës në Krushë të Madhe. "Për të gjithë ata që kontribuan në idenë dhe funksionalizimin e plotë të tij kryetari ndau mirënjohje me motivacionin për kontributin vullnetar (nëntor 2023 - mars

2024) në konceptimin, dizajnimin dhe përgatitjen e ekspozitës muzeale të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe, e cila do të jetë vepër e rëndësishme e kujtesës historike", ka njoftuar komuna e Rahovecit.

Në Muzeun e Masakrës në Krushë të Madhe mund të dëgjoni 202 intervistat e realizuara me të mbijetuarit dhe mund të shihni artefakte e fotografi, që do të na shërbejnë në formësimin e kujtesës kolektive, thirrjes për drejtësi dhe nderimit të viktimave. Muzeu i krimeve serbe të luftës në Krushë të Madhe qëndron si një dëshmi e sakrificave të bëra nga individë të panumërt gjatë luftës së fundit në Kosovë, e cila paraqet sinonimin e dhimbjes, të rezistencës dhe të heroizmit.

Kurti bën homazhe në Marinë në 25-vjetorin e rënies së komandantit Ilaz Kodra

SKENDERAJ, 30 PRILL - Në nderim të rënies heroike të komandantit Ilaz Kodra, kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, bëri homazhe në Kompleksin Memorial në Marinë të komunës së Skenderajt.

Kryeministri Kurti vendosi lule të freskëta në përkujtim të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe

betejës së ashpër me forcat serbe, ku ra heroikisht Ilaz Kodra, komandant i Brigadës 114 "Fehmi Lladrovci", Zona Operative e Drenicës.

Me nderime të përmendorja e ngritur në kujtim të dëshmorëve, kryeministri vendosi lule për 42 dëshmorët e rënë, në krye me Ilaz Kodrën, në mbrojtje të civilëve në Shtuticë,

Verboc, Baks, Gllobar e fshatra përreth, ku ishin grumbulluar dhjetëra mijëra shqiptarë.

Paraprakisht, kryeministri Kurti bëri homazhe në fshatrat Gllobar, Verboc e Shtuticë, ku më 30 prill të vitit 1999, forcat e armatosura të Serbisë kryen masakra kundër popullsisë civile shqiptare.



Bëhen homazhe për veprimtarin Ali Lajçi

PRISHTINË, 30 PRILL - Në ambientet e Kuvendit të Kosovës, aty ku për disa legjislatura Ali Lajçi shërbeu si deputet, e në legjislaturën e fundit të tij edhe si deputet i Lëvizjes Vetëvendosje!

Presidentja Vjosa Osmani, kryeparlamentari Glauk Konjufca, kryeministri Albin Kurti dhe liderë të opozitës kanë bërë homazhe të martën në kujtim dhe nderim të Ali Lajçit. Presidentja Osmani ua ka përcjellë ngushëllimet familjes, miqve dhe bashkëveprimtarëve të Lajçit, teksa ka thënë se ai do të mbahet mend për aktivitetin e tij të pareshtur patriotik përgjatë gjithë jetës.

Ali Lajçi lindi më 3 janar të vitit 1955 në fshatin Malaj të Rugovës.

Ai qysh prej rinisë së hershme është angazhuar politikisht duke qenë edhe një prej emrave që

organizuan demonstratat studentore e popullore të vitit 1981, për çka ai u dënua nga regjimi i Jugosllavisë me 15 vite burgim. Ali Lajçi u lirua nga burgu në vitin 1991, por u arrestua sërish më 1993 për ripërfshirjen e tij në organizime të rezistencës së armatosur. Pas luftës në Kosovë, Ali Lajçi ishte kryetar i komunës së Pejës mes viteve 2001-2007. Pas kësaj ai u zgjodh deputet në Kuvendin e Kosovës në disa legjislatura, ku ishte edhe një nga nënshkruesit e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt të vitit 2008.

Ali Lajçi ka qenë anëtar dhe deputet i Lëvizjes Vetëvendosje! në Kuvendin e Kosovës. Ali Lajçi do të kujtohet për veprimtarinë patriotike dhe angazhimin e tij të pandalshëm politik në Kosovë.



Policia sqaron se pse vendosi kamera në katër komunat veriore

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 PRILL - Policia e Kosovës dhe Agjencia për Informim dhe Privatësi ka njoftuar për vendosjen e sistemit të vëzhgimit me kamerë në komunat e pjesës veriore të Kosovës, i cili aktivitet zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë ndërinstitucional.

Ky aktivitet është bërë në konsultim mes dy institucioneve në ushtrimin e mandatit të tyre ligjor. "Bazuar në Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, Policia e Kosovës është e autorizuar të bëjë vëzhgim parandalues të vendit publik, duke përdorë pajisje për incizime video-akustike dhe pajisje fotografike për t'i vëzhguar vendet publike ku në të kaluarën shpesh janë kryer vepra penale, apo ku ka arsye të bazuar të besohet se vëzhgimi publik do ta zvogëlonte rrezikun nga kryerja e veprave penale dhe do ta përmirësonte sigurinë publike në të ardhmen, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale. Andaj, bazuar në kompetencat e Policisë së



Kosovës, aktiviteti që është duke u zhvilluar sot në komunat e pjesës veriore të Kosovës, është në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Policinë dhe Ligjit për Mbrojtje të të Dhënave Personale, i cili ligj përcakton qartë kushtet dhe masat që duhet të ndjekin autoritetet gjatë përpunimit të të dhënave

personale", ka njoftuar policia. Policia e Kosovës ka bërë me dije se është këshilluar me Agjencinë për Informim dhe Privatësi lidhur me përpunimin e të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë dhe se këto të dhëna do të përpunohen për qëllime të qarta, të ligjshme dhe legjitime, duke garantuar

respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individëve. "Çdo veprim në këtë proces siguron një bazë të duhur ligjore dhe për këtë qëllim, vendosja e sistemit të vëzhgimit me kamerë në komunat e pjesës veriore të Kosovës, është kryer në prezencë të inspektorëve të AIP-së. Nëpërmjet kësaj nisme, Policia e

Kosovës dhe Agjencia për Informim dhe Privatësi theksojnë angazhimin e tyre për të mbrojtur dhe përmirësuar sigurinë publike, duke respektuar plotësisht kuadrin ligjor që rregullon mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtat e qytetarëve", është theksuar në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Kryeprokurori i Shtetit dhe shefi i EULEX-it diskutuan për sundimin e ligjit në Kosovë

PRISHTINË, 30 PRILL - Ushtruesi i detyrës i Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka pritur në takim pune shefin e Misionit të EULEX-it, Giovanni Pietro Barbano. Gjatë këtij takimi kryeprokurori i Shtetit dhe shefi i Misionit të EULEX-it kanë zhvilluar diskutime të frytshme lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Konkretisht në këtë takim u diskutua edhe për mbështetjen e EULEX-it në ruajtjen e pavarësisë

institucionale si dhe ecurinë dhe sfidat për zbatimin e deklaratës së përbashkët të zotimit lidhur me reformën në drejtësi.

Në këtë takim u diskutua edhe për menaxhimin e situatës dhe mbarëvajtjes së punës në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë pas ofrimit të dorëheqjeve të prokurorëve të nacionalitetit serb.

Bashkëbiseduesit patën diskutime edhe për luftimin e veprave penale që ndërlihdhen me pastrimin e parave, nevojën për rritjen e numrit

dhe mbështetjes për mbrojtësit e viktimave të krimit, si dhe çështje të tjera profesionale me interes të përbashkët.

Kryeprokurori Kelmendi ka vlerësuar rolin, përkushtimin dhe mbështetjen e Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhënë në vazhdimësi për institucionin e Prokurorit të Shtetit, me ç'rast ka shprehur gatishmërinë e tij për thellimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen me qëllim të arritjes së sukseseve të përbashkëta.



Gjermania zoton 90 milionë euro për punësim, energji dhe integrim të Kosovës në BE



PRISHTINË, 30 PRILL - Pas përfundimit të negociatave në mes të Kosovës dhe Gjermanisë, qeveria gjermane zotoi një mbështetje shtesë prej 90 milionë eurosh për Republikën e Kosovës për periudhën 2024/2025, prej të cilave 20 milionë euro janë në formë të granteve. Kjo marrëveshje e re shënon rritje të theksuar të vlerës së mbështetjes krahasuar me atë paraprake për periudhën 2022/2023, që ishte në vlerë prej 37 milionë eurosh, duke dëshmuar kështu thellimin e bashkëpunimit në mes të të dyja vendeve. Këto mjete do të destinohen për ta mbështetur integrimin e Kosovës

në Bashkimin Evropian dhe fokusohen në investime në sektorin e energjisë, përkatësisht procesin e dekarbonizimit, garantim të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm, ofrim të trajnimeve dhe punësimit si dhe mbështetje të komunave, veçanërisht në menaxhimin e mbeturinave dhe ruajtjen e mjedisit. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka theksuar bashkëpunimin e ngushtë me qeverinë gjermane, duke përmendur disa projekte të rëndësishme që janë zbatuar në kuadër të këtij bashkëpunimi, siç

është projekti për ndërtimin e ngrrohtores diellore dhe rehabilitimin e ujërave të zeza në Prishtinë, menaxhimin e mbeturinave në të gjithë Kosovën si dhe themelimin e Parkut të Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) në Prizren.

Sa i përket mbështetjes së zotuar, ministri Murati falënderoi qeverinë gjermane, duke potencuar se një mbështetje e tillë forcon edhe më tutje marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve, promovon zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe e përaftron atë me Bashkimin Evropian.

Në Sojevë të Ferizajt KEDS-i ka ndryshuar komplet gjendjen energjetike

FERIZAJ, 30 PRILL - Natyrës së bukur të fshatit Sojevë po i shkon për shtati edhe rrejtja e ri elektrik. KEDS-i aty sapo hoqi edhe shtyllën e fundit të drurit, duke përfunduar të gjitha punimet investive në një rrjet krejtësisht të ri energjetik. Banorët tani do të kenë furnizim stabil me rrymë.

Gjatë implementimit të këtij projekti, KEDS-i ka vendosur shtylla të reja të betonit të tensionit të mesëm dhe të ulët.

Ndryshimet që ka bërë KEDS-i në fshat janë shumë të mirëseardhura për banorët të cilët jetojnë atje. Familja Ramadani i është shumë

mirënjohëse KEDS-it. Ajo thotë se ua ka pa hairin këtyre investimeve. "E kena pas rrjetin nëpër kodra dhe si frynte era, u nalke rryma. Tash e kanë zhvendos afër rrugës dhe gjithçka është në rregull", thotë Arjan Ramadani.

Zonja e shtëpisë, Afërdita, thotë se tashmë nuk do të ketë pengesa për ta zhvilluar biznesin e tyre të vogël familjar. "E kena një fermë të vogël lopësh dhe shpesh na është dashtë me i mjetë ato me dorë, se shkaku i rrymës nuk punonin pajisjet. E tash që u ndreq rryma jena të sigurt dhe nuk kemi probleme", thotë Afërdita. KEDS-i ka njoftuar se vazhdimisht

është duke investuar në distriktin e Ferizajt. Vetëm vitet e fundit janë rreth 64 projekte që janë duke realizuar nëpër të gjithë distriktin. Vetëm në qytet dhe rrethinë janë 21 projekte që po realizohen, duke përfshirë linjat 10 kV që do t'i rritin kapacitetet bartëse si dhe përmirësimin e rrjetit 0.4kV në lagjet brenda qytetit dhe fshatrave.

Projekte të kështilla janë duke u implementuar jo vetëm në rajonin e Ferizajt, por gjithandej Kosovës dhe sipas Planit Zhvillimor të Shpërndarjes së Energjisë, parashihet që brenda këtij viti të realizohen 250 projekte kapitale.



Bregu me rastin e Ditës së Punëtorëve: Pabarazitë gjinore vazhdojnë në fuqinë punëtore



SARAJEVË, 30 PRILL - 1 Maji për punëtorët në Ballkanin Perëndimor dhe në gjithë botën është, mbi të gjitha, një moment reflektimi mbi betejat e vazhdueshme për përmirësimin e kushteve të punës, ikjen e trurit, papunësinë afatgjatë dhe punën e padeklaruar. "Normat e punësimit në Ballkanin Perëndimor kanë arritur rekordin e lartë prej 60,5% në vitin 2023, ndërsa kjo shifër ngjall optimizëm, duhet pasur kujdes për arsyet që qëndrojnë pas saj", tha sekretarja e përgjithshme e RCC-s, Majlinda Bregu, në hapje të videos me rastin e 1 Majit, Ditës së Punëtorëve. Pabarazitë gjinore vazhdojnë në

fuqinë punëtore, me gratë që mbeten prapa burrave me 15%. Sfidat tilla si papunësia afatgjatë, puna e padeklaruar, krahas tendencave shqetësuese të emigrimit dhe ikjes së trurit, vazhdojnë të mbizotërojnë. "Një e pesta e popullsisë së Ballkanit Perëndimor jeton jashtë vendit, ndërsa sipas edicionit më të fundit të Barometrit Ballkanik të RCC-së, 71% e të rinjve tanë mendojnë ta lënë shtëpinë e tyre dhe të largohen jashtë vendit", shtoi Bregu. Ajo ka thënë se janë të shumta arsyet që bëhen shkak për largimin e shpejtë të qytetarëve nga rajoni. "Nga standardet më të ulëta të jetesës në krahasim me ato në

vendet e destinacionit, te mbrojtja e dobët sociale dhe nivelet e larta të korrupsionit. Sipas Barometrit Ballkanik, politikat që synojnë ta mbajnë fuqinë punëtore të rajonit kanë popullaritet të rritur në mesin e bizneseve të Ballkanit Perëndimor me një mbështetje rekord prej 70%, një rritje prej 24 pikësh që nga viti 2021. Megjithatë, edhe pse 40% e bizneseve vendase do të preferonin më shumë punëtorë nga Ballkani Perëndimor, ata drejtohen drejt vendeve të treta, duke importuar punëtorë të kualifikuar për t'i plotësuar vendet e tyre të lira, dhe kuota për dhënien e lejeve të punës është çdo vit më e lartë në ekonomitë e rajonit", ka pohuar ajo.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së miraton tremujorin e parë të këtij viti

PRISHTINË, 30 PRILL - Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka mbajtur mbledhjen e radhës ku, ndër të tjera, shqyrtoi dhe e miratoi raportin tremujorin të këtij viti 2024 për Komisionin Parlamentar për Ekonomi, Industri dhe Tregti. Po ashtu, Bordi diskutoi dhe e vlerësoi

Rezolutën e Kuvendit të Kosovës për punën e AKP-së për vitin 2022 dhe u zotua se do t'i zbatojë me përpikëri rekomandimet që dalin nga kjo rezolutë.

Gjatë kësaj mbledhjeje Bordi u informua edhe për punën e menaxhmentit të kësaj Agjencie për periudhën

paraprake njëmuajore për Agjencinë, si dhe shqyrtoi raportin mujor për "N. Sh. Brezovica", e cila është nën administrim të AKP-së, ndërkaq u informua edhe me Raportin vjetor të Komitetit të Auditimit për vitin e shkruar 2023. Në këtë takim Bordi shqyrtoi dhe aprovoi edhe

Raportin e Komisionit të Banesave të NSH-ve që është i themeluar në kuadër të AKP-së. Bordi i Drejtorëve diskutoi edhe për çështje të tjera në kuadër të veprimeve që po ndërmerren në AKP për t'i përmirësuar proceset e administrimit dhe menaxhimit sa më të mirë të pasurisë shoqërore.



Rishikimi i dekadave të fundit të Mikelanxhelos

Nga: Jonathan JONES /
The Guardian
Përkthimi (i pjesëshëm):
Telegrafi.com

Lordi Elgin, na ke zhgënjyer. Nga të gjitha kryeveprat e artit botëror që koleksionistët grabitqarë të Britanisë rrëmbyen këtu dhe atje, a nuk mund ta merrje një statujë të Mikelanxhelos [Michelangelo Buonarroti]? Jo, e vetmja vepër origjinale në mermer nga skulptori, piktori, arkitekti dhe poeti i madh në një koleksion britanik, është një relief në pronësi të Akademisë Mbretërore. Ajo që ne kemi janë posedimet e vizatimeve të tij në Muzeun Britanik dhe në Koleksionin Mbretëror. Fatkeqësisht, përdorimi i këtyre veprave në letër nga Muzeu Britanik, në përpjekjen për të ndriçuar jetën e tij të



I mbushur me epsh ... "Ndëshkimi i Titit"

mëvonshme, tregon se ato nuk kanë vlerë të madhe. Zhgënjimi është i dukshëm që në fillim [të ekspozitës Michelangelo: Dekadat e fundit]. Pasi ndikoheni nga portreti i të moshuarit me mjekër, nga portreti i Mikelanxhelos i realizuar nga nxënësi i tij më i talentuar, Daniele da Volterra, zhyteni në skicat e tij për *Gjykimin e fundit* që është pikturuar në murin e altarit të Kapelës Sistine – nga viti 1536 deri në vitin 1541. Mikelanxhelo ishte në fillim të të gjashtëdhjetave kur u rikthye në skenën e triumfit të tij të mëparshëm, për të krijuar vizionin e tij rrënues të trupave që ngriheshin në Parajsë dhe binin në Ferr kundrejt një të kaltre të thellë. Këtu janë skicat e tij të nudove të mbushura me muskuj, duke u munduar dhe duke luftuar – apo duke u përqafuar? – nga dëshpërimi për t'u bashkuar me radhët e të bekuarve. Megjithatë, nuk mund t'i ndaja sytë nga pasqyrimi i afreskut aktual, ose ta ndalja dëshirën të isha atje me gjënë e vërtetë, në Kapelën Sistine.

Arti monumental i

Mikelanxhelos nuk është aq i përjetshëm. Vizatimet, jo aq shumë. Ato janë, ndoshta çuditërisht, më pak intime sesa veprat e tij më të mëdha. Ndoshta sepse Mikelanxhelo jetoi në një shkallë të gjerë, duke e parë veten si hero. Vetvetja ishte kur gdhendte një kolos ose vendoste një kube në horizontin e një qyteti.

Megjithatë, kjo nuk duhet të na bëjë të shurdhër ndaj ekspozitës së vizatimeve të tij. Ekspozita e heq dramën nga jeta. Nuk përmendet rreziku dhe konflikti që mbërtheu *Gjykimin e fundit*, një kryevepër kjo shumë personale. Edhe kur ishte duke e pikturuar, u akuzua se e ktheu Kapelën e Papës në "hamam" duke e mbushur me nudo. Nuk ka asnjë aluzion këtu për thashethemet e bazuara se Mikelanxhelo tërhiqej seksualisht nga burrat. Aty pranë ekspozitës shfaqen



Studim i Michelangelos për "Gjykimin e fundit"

është që Mikelanxhelo i thotë Tommasos se për të ai vlen më shumë sesa ushqimi, sepse ndërkohë që mban vetëm trupin e vet, i dashuri e ushqen "si trupin edhe shpirtin".

Trupi dhe shpirti. Nuk mund ta kesh shpirtin e Mikelanxhelos pa trupin e vet. Hiqeni trupin nga Mikelanxhelo dhe vriteni. Nuk i merr as idetë neoplatoniste që formojnë vizatimet e tij. Sipas tyre, dashuria për të bukurën mund ta çojë shpirtin lart në Parajsë: ata e lejuan Mikelanxhelon të tregojë burra të përqafuar dhe të puthur në vetë *Gjykimin e fundit*, e dukshme këtu në këtë ekspozitë kur shikon

mjaftueshëm ilustrimin.


Ekspozita kalon nga dëshira fizike në teologji. Kjo flet për miqësinë e Mikelanxhelos me poeten Vittoria Colonna. Kjo marrëdhënie me shkronja dhe vargje ishte vërtet e dëlirë. Është e qartë se duhet t'i shohim miqësitë e Mikelanxhelos me Cavalierin dhe Colonnin si paralele ekzakte, po aq aseksuale. Por, letrat dhe poezitë drejtuar Tommasos rrëfejnë dëshirën trupore si dhe shpirtërore. Dhe, ato pasqyrojnë pasionin e tij të përjetshëm për trupin mashkullor në art. Vizatimet në këtë ekspozitë të Davidit mbi Goliatin janë pjesë e një teme të

përsëritur në artin e tij të rinjve që nënshtrojnë të moshuarit të mbushur me tension seksual.

Kjo ekspozitë nuk tregon asgjë nga këto. Në vend të kësaj, mezi pret ta çojë në shtratin e vdekjes. Këmbëngul se preokupimi i vërtetë i Mikelanxhelos tekta plaket ishte mirëqenia e tij shpirtërore. Vizatimet e fuqishme të Krishtit në kryq janë paraqitur si provë. Por, a ishte ai aq i pabotë sa tregohet? Ai ishte padyshim i fiksuar pas famës, jashtëzakonisht konkurrues dhe disa thoshin se merrte para. Kur Vasari e quajti artistin më të madh të të gjitha kohërave, nuk mbeti i kënaqur, por ia rrëfeu jetën e vet nxënësit të tij, Condivit. Të dy librat e tyre janë në ekspozitë, por nuk ka asnjë eksplorim të rrëfimeve apo të natyrës së paprecedentë të personazhit të famshëm artistik të Mikelanxhelos.

Kaq shumë gjëra interesante janë përjashtuar. Në vend të kësaj, kemi shumë nga "nxënësit" e tmerrshëm të Mikelanxhelos. Mikelanxhelo shpeshherë i lejoi të bënin piktura bazuar në skicat e tij, dhe ekspozita përfshin shumë nga këto lyerje të tmerrshme, të shfaqura në mënyrë të lodhshme pranë vizatimeve të Mikelanxhelos ku janë bazuar. Më e keqja nga të gjitha është versioni i pikturuar nga Condivi i vizatimit ose "karikaturës" së Mikelanxhelos – në pronësi të Muzeut Britanik – i quajtur *Epifania*.

Ende je zgjuar? Nëse je në ekspozitë, më ke mundur. Jam fiksuar pas këtij artisti, por e pata një punë të vështirë. Fokusi ekskluziv në jetën shpirtërore të Mikelanxhelos nuk lidhet vetëm me seksualitetin, por edhe me artin e tij. Kujt i drejtohet? Kisha Katolike, mendoj, mund të jetë e lumtur. /Telegrafi/



"Krishti në kryq" i Mikelanxhelos

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport



Sonte përballja e katërt mes Yllit dhe Pejës

SUHAREKË, 30 PRILL - Beteja mes Golden Eagle Yllit dhe Pejës do të vazhdojë të mërkurën mbrëma për kualifikim në finale të "play-off"-it në Prince Caffè Superligë. Therandasit po fitojnë 2:1 në serinë

gjysmëfinale dhe u nevojitet edhe një fitore për kualifikim, kurse pejanët duhet të fitojnë të mërkurën mbrëma edhe në sfidën e ardhshme, për t'u gjendur sërish në finale. Në takimin e parë fituan

therandasit 84:87, ashtu si edhe në ndeshjen e dytë, 92:86, derisa në ndeshjen e tretë në Gjakovë, fituan pejanët 98:86. Ky është një duel mes kampionit aktual dhe ish-kampionit. Trepça është kualifikuar në finale,

pasi eliminoi Sigal Prishtinën në gjysmëfinale 3:0.

GJYSMËFINALJA 4

Të mërkurën takohen:
19:00 Golden Eagle Ylli - Peja



Tjetër përballje mes Dortmundit dhe PSG-së

"Epoka e re"

DORTMUND, 30 PRILL - Borussia Dortmund dhe Paris Saint-Germain janë prej katër skuadrave më të suksesshme në Ligën e Kampionëve për edicionin 2023/2024, pasi ishin së bashku në grup dhe kanë arritur deri në fazën gjysmëfinale. Në përballjet në kuadër të Grupit F, PSG-ja fitoi si vendas me rezultat 2-0, ndërsa në Gjermani rezultati ishte 1-1. Sonte (e mërkurë) këto dy skuadra e ndajnë mejdantin në kuadër të ndeshjes së parë gjysmëfinale, e cila zhvillohet në "Westfalenstadion". Në çerekfinale këto dy klube eliminuan skuadrat spanjolle. Dortmundi eliminoi Atletico Madridin, kurse PSG-ja eliminoi Barcelonën dhe tash do të luftojnë për plasman në finalen e madhe. Në fundjavë, në kuadër të Bundesligës, Dortmundi pësoi humbje të thellë nga RB Leipzig (4-1) dhe aktualisht është në

vendin e pestë. Kjo skuadër pritet të jetë pjesëmarrëse edhe edicionin tjetër në garën më të fortë në futboll. Në nën tjetër, Parisi ishte duke humbur nga Le Havre me rezultat 1-3, por me dy golat e Mbappes dhe Ramosit në minutat shtesë arriti të shpëtojë nga humbja dhe në këtë mënyrë festoi edhe titullin në Ligën 1. Mungesat e klubit gjerman për ndeshjen e parë janë Ramy Bensebaini dhe Sebastien Haller, derisa në dyshim mbesin Ian Maatsen dhe Donyell Malen. Për klubin francez mungojnë Presnel Kimpembe, Layvin Kurzawa dhe Sergio Rico.

FORMACIONET E MUNDSHME:

BORUSSIA DORTMUND: Kobel; Ryerson, Hummels, Schlotterbeck, Maatsen; Sabitzer, Can; Adeyemi, Brandt, Sancho; Fullkrug.
PARIS SAINT-GERMAIN: Donnarumma; Hakimi, Marquinhos, Danilo, Hernandez; Vitinha, Zaire-Emery; Dembele, Aensio, Barcola; Mbappe.



MVP në Kupë, Esati: Është vetëm fillimi i një rrugëtimi të jashtëzakonshëm



FERIZAJ, 30 PRILL - Liridon Esati është shpallur lojtari më i vlefshëm (MVP) i turneut final të Kupës së Kosovës në hendboll. Me pritje të shumta, portieri Esati udhëhoqi mbrojtjen e Kastriotit që të dielën e fitoi finalen ndaj Besa Famgasit. Esati u shqua edhe në gjysmëfinale ndaj Trepçës. Kastrioti ka fituar trofe pas shumë vjetësh, ndërsa ferizajasit tani kanë synime dukshëm më të mëdha. Liridon Esati, po ashtu.
"Jam i lumtur që kam pranuar këtë çmim të shkëlqyer si MVP i Kupës së Kosovës në hendboll. Është një nder i madh për mua dhe një moment që do të mbaj gjithmonë

në kujtesë. Dua ta falënderoj ekipin tim të shkëlqyer, KH Kastrioti, stafin trajnues dhe bordin drejtues të klubit për përkushtimin dhe bashkëpunimin gjatë gjithë turneut. Tifozët e Kastriotit kanë qenë një burim i jashtëzakonshëm i energjisë dhe mbështetjes, dhe për këtë i falënderoj thellësisht. Ky sukses nuk është vetëm për mua, por për të gjithë ekipin tonë. Kemi punuar fort për të arritur këtë objektiv, dhe është një ndjesi e mrekullueshme t'i shohim përpjekjet tona të shpërblehen në këtë mënyrë", ka thënë Esati. Ai u kthye në janar nga Trepça. Kastrioti tani nis sulmin për titull të

kampionit. "Ky çmim më nxit për më shumë angazhim dhe përkushtim për të vazhduar të përparoj dhe të jap maksimumin në fushën e hendbollit. Synimi im është të vazhdoj të përmirësohem dhe ta ndihmoj ekipin tim të zëmërës të arrijë suksese edhe më të mëdha në të ardhmen. Faleminderit për këtë çmim të madh, dhe uroj që ky të jetë vetëm fillimi i një rruge të gjatë dhe të suksesshme për ne si ekip dhe për mua personalisht në karrierën sportive. Faleminderit për mbështetjen dhe për këtë mundësi për të ndarë këtë moment me të gjithë ata që më kanë mbështetur në rrugën time", ka shtuar Esati.

Hasi arrin marrëveshje me Gentin

GHEENT, 30 PRILL - Edhe zyrtarisht Besnik Hasi nuk është më trajner i skuadrës së Mechellenit në elitën e futbollit belg. Ish-kapiteni i kombëtares shqiptare e mbylli

bashkëpunimin me klubin, ndonëse do të vazhdojë ta drejtojë ekipin edhe në katër ndeshjet e mbetura të fazës "play-off", që mund t'i sigurojnë një vend në

kualifikueset e Ligës së Konferencës. 52-vjeçari ka arritur pajtim me skuadrën që humbi garën për një vend në kualifikueset e Ligës së Konferencës, Gent, dhe tashmë

pritet vetëm nisja e sezonit të ardhshëm. Ku, përveç pretendimeve për ta fituar titullin kampion, pritet edhe një garë e zjarrtë në kompeticionin evropian.



Sabrina Fiore, e lumtur për Kupën dhe çmimin MVP

FERIZAJ, 30 PRILL - Sabrina Fiore ishte prej lojtareve më të mira të Ferizajt në turneun final të Kupës së Kosovës në hendboll. Hendbollistja nga Paraguai u shpall lojtarja më e vlefshme (MVP). Çmimin e vlefshëm ia dorëzoi zëvendësministria për

Kulturë, Rini dhe Sport, Daulina Osmani. Fiore u shqua në të dyja ndeshjet në palestrën "Karagaçi" në Pejë, në gjysmëfinale ndaj Samadrexhës dhe në finale ndaj Istogut. "Jemi shumë të lumtura me rezultatin. Kemi kaluar shumë vështirësi

për të arritur ku arritëm. Ne punojmë dhe ushtrijmë shumë për ta dërguar emrin e klubit sa më lart dhe së bashku tregojmë se sa potencial kemi. Kemi grup të balancuar që ka shumë dëshirë për fitore. Jam, po ashtu, shumë e lumtur me çmimin

MVP. Është rezultat i angazhimit të madh dhe dedikimit të përditshëm. Jemi shumë të lumtura që sollëm Kupën në Ferizaj dhe të motivuara për të vazhduar me shumë punë për pjesën e mbetur të stinorit", ka thënë Sabrina Fiore.



Asllani: Festova shumë se jam edhe tifoz i Interit

TIRANË, 30 PRILL - Flamurin shqiptar nuk e hoqi kurrë që nga fillimi i festës me autobus deri kur skuadra mbërriti në "Duomo". Kristjan Asllani ishte një nga protagonistët e festës zikaltër, tashmë i përfshirë maksimalisht në grupin e skuadrës. Me buzëqeshjen që nuk iu largua nga fytyra si për të treguar se ishte njeriu më i lumtur në botë, shpeshherë edhe me ndonjë goditje nga euforia e shokëve të skuadrës, Kristjan festoi si i çmendur. Nuk ngurroi që në autobusin e festës të merrte edhe një banderolë të "Inter Club Albania"-s që konfirmonte se Shqipëria ishte e pranishme në festë.



Mendon se qëndrimi ishte gjëja e duhur?

Asllani: Unë që në sezonin e kaluar vendosa që të qëndroja, pastaj erdhi largimi i Brozoviçit dhe shanset që të luaja këtë sezon ishin më të mëdha. E dija që përpara kisha një lojtar të fortë si Hakan Çalhanoglu, të cilin e shoh përditë në stërvitje. Jam rritur dhe jam përmirësuar shumë prej tij. Kam pasur një raport të shkëlqyer me të. Më flet si brenda dhe jashtë fushës së lojës. Dua ta falënderoj atë, ashtu si të gjithë skuadrën. Jemi një grup lojtarësh të përlulur dhe kjo është e rëndësishme.

Kush ka qenë kapiteni i kësaj feste të Interit?

Asllani: Të gjithë janë duke festuar si të shfrenuar, por ndoshta tre

kryesorët janë Lautaro, Dimarko dhe Barela. Pastaj ka edhe të çmendur si Fratezi dhe Arnautoviç. Më kanë bombarduar me goditje. Po pres me padurim që ta mbyllim këtë sezon që të pushoj 25 ditë. Kam frikë që të reagoj ndaj Arnautoviçit sepse është shumë i madh...

Sa vlen ky titull për ju Asllani?

Asllani: Për mua vlen dyfish dhe duhet ta pranojë këtë. Unë jam tifoz i Interit. Fitorja e titullit me këtë skuadër është diçka e jashtëzakonshme. Kur kam qenë i vogël kurrë nuk e kisha menduar se do të përjetoja një moment kaq të jashtëzakonshëm. Jam shumë i lumtur dhe shpresoj që të vazhdojmë kështu edhe në sezonet e ardhshme.

Kristjan, e prisnit kaq shumë dashuri dhe mbështetje nga ana e tifozëve?

Asllani: Të jem i sinqertë nuk besoj që do të kishte kaq shumë njerëz. Po më dhemb koka nga koret dhe këngët e shumta. Por jemi shumë të kënaqur që i shohim tifozët tanë të lumtur. Është një krenari për të gjithë sepse ata kanë qenë të rëndësishëm për të na dhënë mbështetje në çdo moment.

Ju bëtë një zgjedhje të fortë sepse edhe pse kishit përpara në hierarki Brozoviçin dhe Çalhanoglin qëndruat. Mund të ishte më e lehtë që të huazoheshit në një tjetër ekip.

Denveri fiton ndaj lakersave dhe kalon në raundin e dytë të 'play-off'-it

DENVER, 30 PRILL - Denver Nuggets ka arritur ta kalojë raundin e parë të "play-off"-it në ligën NBA. Nuggets triumfoi në një ndeshje tejet të vështirë përballë Los Angeles Lakersit me dy pikë diferencë 108:106 dhe me serinë 4:1 kaloi tutje. Denveri e nisi mirë ndeshjen, duke e fituar çerekun e parë me plus katër, por shpejt erdhi përgjigja e lakersave në çerekun e dytë, me plus shtatë. Fitorja e Denverit erdhi në çerekun e tretë të cilin e fitoi me pesë pikë avantazh, derisa ai i fundit u mbyll baras. Te Nuggets Jamal Murray ishte fantastik me 32 pikë, duke përfshirë edhe dy të fundit në ndeshje, derisa Nikola Jokic shtoi 25 të tjera. Nga ana tjetër, i shkëlqyeshëm ishte edhe LeBron



Jamesi me double-double me 30 pikë e 11 asistime, si dhe Anthony Davis me double-double 17 pikë dhe 15 kërcime, por që nuk mjaftuan për fitore dhe kështu u eliminuan. Në raundin e dytë të "play-off"-it në Konferencën e Perëndimit, Denveri do të luajë kundër Minesotas, që fitoi me lehtësi 4-0 ndaj Phoenixit. Kalimin në rrethin e dytë e siguroi edhe Oklahoma City Thunderi 97:89 ndaj New Orleans Pelicansit dhe

kaloi tutje me lehtësi 4-0. Fitoren Thundersi e siguroi në çerekun e fundit, të cilin e mbylli me plus nëntë pikë. Oklahoma në raundin e dytë do të luajë kundër Los Angeles Clippersit ose Dallas Mavericksit. Rezultati në atë seri është 2:2. Hap të madh drejt kualifikimit në raundin e dytë bëri Boston Celticsi me fitoren 102:88 në Miami. Momentalisht, Celticsi ka epërsinë prej 3:1 në seri. Bostoni ishte skuadër më e mirë në tre çerekët e para të lojës. Krejt çka arriti Miami ishte fitimi i çerekut të fundit. Fituesi i duelit Boston - Miami në raundin e dytë të Lindjes do të luajë kundër skuadrës më të mirë nga dueli Cleveland-Orlando. Edhe atje seria është e barabartë 2:2.

SHKURT

Fanol Shala thyen rekordin botëror në paragllajzëm

Paragllajdisti kosovar Fanol Shala ka arritur rezultat mbresëlënës në Kupën e Botës (seria e dytë) disiplina paragllajding precizion, të mbajtur në Alania të Turqisë. Shala u rendit i dyti nga 69 garues, me gjashtë pikë në total, por ajo që e veçoi më shumë ishte rekordi botëror. Shala pati gjashtë ulje radhazi me rezultat 1 cm (total 6 cm), duke thyer rekordin botëror, të konfirmuar pas garës edhe nga Federata Ndërkombëtare e Aeronautikës. Vendin e parë e zuri kampioni botëror, kinezi Yang Chen. Paraqitje të mirë patën edhe garuesit e tjerë të Kosovës, Veton Sylaj, Migjen Shala, Gezim Statovci dhe Avni Kuçi.

Torino, West Ham dhe Newcastle në garë për Sarrin

Maurizio Sarri është gati të nisë një aventurë të re në stol pas largimit nga Lazio. Sipas asaj që shkruhet nga "TuttoMercatoWeb.com", ka shumë opsione për t'u shqyrtuar, përveç Torinos që e shikon si hipotezë, është mbi të gjitha Premierë Liga ajo që po "tundon" trajnerin. West Hami dhe Newcastle janë alternativa të mira, me "Magpies" që mbetet në pole position. Në fakt, duket se pronarët arabë të Newcastle's i kanë paraqitur një ofertë shumë të rëndësishme trajnerit toskan, i cili po mendon seriozisht ta pranojë propozimin. Kalimi i Sarrit në elitën angleze duket ide interesante, për vetë faktin se ka drejtuar më parë një ekip si Chelsea.

Milani heq dorë nga Lopetegui

Julen Lopetegui nuk do të jetë trajner i Milanit. Ndonëse kuqezinjët kishin një pajtim paraprak me trajnerin e njohur spanjoll, në fund kanë vendosur të bëjnë një hap pas dhe shkak për këtë janë bërë tifozët. Këta të fundit kanë shprehur gjithë kundërshtinë e tyre në rrjetet sociale, duke mos miratuar spanjollin si të duhurin për stolin e Milanit dhe kaq ka mjaftuar që drejtuesit e klubit, në krye me Ibrën, të heqin dorë nga Lopetegui. Tifozët e Milanit krijuan edhe një hashtag "#Nopetegui", i cili shumë shpejt mori miliona shpërndarje, sinjal ky i qartë për drejtuesit që të hiqnin dorë nga spanjollit. Ndërkohë është kthyer fuqishëm në garë Domenico Tedesco, aktualisht trajner i Belgjikës, i cili më herët ka drejtuar edhe gjermanët e Leipzigut, ku ka bërë punë të mirë. Emra të tjerë që kanë fituar pikë së fundi janë edhe italianit De Zerbi e francezi Galtier, teksa te Milani duken të vendosur ta gjejnë trajnerin e ri brenda muajit maj në mënyrë që ta nisin ndërtimin e skuadrës për sezonin e ri, bashkë me të. Ndërkohë, ekziston edhe ëndrra për të sjellë në Milano, Antonio Conten.

Lewandowski dëshiron të qëndrojë në Barcelonë

Synimi i sulmuesit të Barcelonës, Robert Lewandowski, është gati të qëndrojë në "Camp Nou". 35-vjeçari iu bashkua gigantëve katalanas për 45 milionë euro të raportuara në korrik 2022 pas një periudhe tetëvjeçare jashtëzakonisht të suksesshme te Bayern Muncheni. Lewandowski bëri përshtypje në sezonin e tij debutues në "Camp Nou" dhe shënoi 33 gola në 46 ndeshje, të paktën 23 gola më shumë se çdo bashkëlojtar i tij, për ta ndihmuar Barcelonën ta fitojë titullin e La Ligës dhe Superkupën e Spanjës më 2022-23. Reprerentuesi polak që atëherë ka shënuar 23 herë në 44 paraqitje në të gjitha competitionet këtë sezon, duke përfshirë një hat-trick në fitoren 4-2 të Barçës në shtëpi ndaj Valencias në La Liga të hënën, duke e çuar numrin e golave të tij më të mirë në 16 në 30 ndeshje. Sidoqoftë, Barcelona do ta përfundojë sezonin aktual pa trofe dhe ka pasur sugjerime që Lewandowski, kontrata e të cilit skadon në qershor 2026, mund të kërkojë kullota të reja në të ardhmen e afërt.

Spalletti fton legjendat e Italisë në fazën përgatitore

Me futbollin e luajtur janë ndarë prej vitesh. Për këtë arsye nuk mund të zbresin në fushë, por gjithsesi kanë shumë për të dhënë nga përvoja e fituar në karrierat e tyre fantastike.

Trajneri i Kombëtares së Italisë, Luciano Spalletti, ka zbuluar idenë e tij krejt origjinale për t'i shtuar dozat e vetëbesimit të lojtarët e tij përpara "Euro 2024", ku debutimin do ta bëjë pikërisht kundër

Shqipërisë më 15 qershor në ndeshjen e parë të Grupit B. Teknika ka vendosur të ftojë në fazën përgatitore disa prej emrave më të mëdhenj të historisë së vonshme të përfaqësueses italiane,

si Roberto Baggio, Francesco Totti, Alessandro Del Piero dhe Giancarlo Antognoni.

Në një intervistë për "Corriere Dello Sport", Spalletti ka treguar se këtë kërkesë ia ka bërë Federatës Italiane,

që shumë shpejt do të nisë ftesat për ish-futbollistët e famshëm. Sipas teknikut, prania e tyre në përgatitjet e skuadrës do t'i shtynte futbollistët e tij ta rrisnin nivelin dhe besimin përpara Kampionatit Evropian.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Petrol Company" Sh.p.k. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për piken e karburanteve në Dresnik komuna e Klinës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 24.06.2024 në ora 10:00 në Shkollën e Mesme Teknike "Fehmi Agani" në Klinë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Petrol Company" Sh.p.k. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Petrol Company" Sh.p.k. Prishtinë për piken e karburanteve në Dresnik komuna e Klinës.

<https://mmpfi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin ynm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Thirrja për aplikim (DHËNJE TË OFERTËS)

"SINAN AVDULLAHI" B.I. me numer Unik:812154516 me seli Popoc rruga Dëshmoret e Popocit p.n. Komuna Gjakovë me pronar **SINAN AVDULLAHI**, po kërkon një ofertues / kontraktor / kompani, të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për **mallrat/punët/shërbime** këshilluese si në vijim: për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre Makinerive dhe Paisjeve Bujqësore dhe energji solare:

1. **Kombajë per korrje (qvoshe te Misrit) 4 rendore;**
2. **Rimorkio 8 ton me dy akse,**
3. **Pllug 3 brazesh rrotullues me plluge ndihmes,**
4. **Energji Solare 3.5 kw.**

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek "**SINAN AVDULLAHI**" B.I. - **SINAN AVDULLAHI** (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë **(5 ditë nga data e publikimit)**

Afati i dorezimit të Ofertave **10 ditë nga data e pranimit të ftesave** për kuotim, ofertat dorëzohen në Adresën: Popoc rruga Dëshmoret e Popocit p.n. Komuna Gjakovë
Për Informata Shtesë tel: **+383 44 246 272** dhe në email adresën: **ermalavdullahi@homail.com**



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ndërmarrja Tregtare "Moda", shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nr. 811609562.
- Sabedin Zijadin Redonica shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Shtjefën Gjeçovi" Prishtinë.
- Arben Pnishi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e sh.m.e. "Kadri Kusari".
- Emir Kerco shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.
- Besnik Sula shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Nedziba Aslani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Meto Bajraktari " Recane.
- Njomza Dervishaj nga Rracaj e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 6-9 e lëshuar nga shkolla fillore e mesme e ultë "3 Dëshmorët", Sheremet-Gjakovë.
- Pjetër Berisha nga Korenica e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 1-8 e lëshuar nga shkolla fillore "Luigj Gurakuqi", Korenicë-Gjakovë.
- Floriana Gashi nga Roga e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të klasës 1-5 dhe 6-9 të SH.F.M.U "Haxhi Hoti", Rogovë.
- Arben Hoti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.T "Nexhmedin Nixha", drejtimi MEKANIK, Gjakovë.
- Enise Shuki shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Motrat Qiriaz " Prizren.
- Bejadin Dervishaj shpall të pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Jashar Krasniqi nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plot të shkollës fillore Kongresi i Manastirit Damjan KK Gjakovë.
- Astrit Tahiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.
- Alban Meta nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë prej klasës 1-8 të shkollës fillore "Selman Riza", Gjakovë.
- Fatlinda Gjuraj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesëm të mjekësisë "Hysni Zajmi", Gjakovë.
- Bekim Veljiji shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.
- Nexhmedin Tulla shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, NPT Gimi O.P Gjonaj, Prizren në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për objektin montazhe dhe deponin për riciklimin e mbeturinave të ngurta në Dushanovë komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 21.06.2024 në ora 10:00 në Shkollën Sh.F.M.U "Ibrahim Fehmiu" Arbanë-Prizren, do të organizohet debat publik nga Kompania NPT Gimi O.P Gjonaj, Prizren në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmpha1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë NPT Gimi O.P Gjonaj, Prizren për objektin montazhe dhe deponin për riciklimin e mbeturinave të ngurta në Dushanovë komuna e Prizrenit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnv.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Shala Gas" Sh.p.k Suharekë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për deponinë e gazit të lëngët naftor në Suharekë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 26.06.2024 në ora 10:00 në Shkollën Sh.M.T. "Skender Luarasi" Suharekë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Shala Gas" Sh.p.k Suharekë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmpha1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Shala Gas" Sh.p.k Suharekë për deponinë e gazit të lëngët naftor në Suharekë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnv.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

